

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË KOMUNËN QUKËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Komunën Qukës me objekt: “menaxhimin financiar e kontrollin e brendshëm, hartimin dhe zbatimin e buxhetit të komunës, mbajtjen e kontabilitetit, administrimin, ruajtjen e dokumentimin e vlerave monetare e materiale, prokurimet publike, parashikimin e realizimin e të ardhurave, veprimtarinë në fushën e urbanistikës, inspektoratit ndërtimor, administrimin e aseteve, qiradhëniet, veprimtarinë e Policisë së Komunës, etj.” për periudhën 01.01.2009-31.12.2011 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 112, datë 30.06.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 419/10, datë 30.06.2012, dërguar z. **Fatmir KRYEZIU**, Kryetar i Komunës, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

Ti propozohet Agjencisë së Prokurimit Publik për të paraqitur në Këshillin e Ministrave, disa përmirësime ligjore në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshime, kreu i V-Zhvillimi i procedurave, si më poshtë:

- Pika 1- Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim, germa “b”, fjalia e dytë: “Njësia e Prokurimit përbëhet të paktën nga 3 persona me arsim të lartë, ku njëri prej tyre duhet të jetë jurist”, të riformulohet si më poshtë:

“Njësia e Prokurimit përbëhet të paktën nga 3 persona me arsim të lartë, ku njëri prej tyre duhet të jetë jurist dhe 2 të tjerë specialist të fushës sipas objektit të prokurimit”.

- Pika 4-Hapja edhe vlerësimi i ofertave, germa “a”, fjalët në paragrafin e dytë “Ata mund të japin mendime vetëm kur u kërkohet..”, të riformulohet si më poshtë:

“Ata japin mendim me shkrim për rregullshmerinë e dokumenteve të paraqitura nga kandidatët për çdo rast”.

germa “c”, fjalia e fundit: “Kohëzgjatja e procedurës nuk duhet të kalojë 20 ditë”, të riformulohet si më poshtë:

“Kohëzgjatja e procedurës nuk duhet të kalojë më shumë se 7 ditë”.

- Fjalët në fund të paragrafit të germës “d”: “jo më vonë se 20 ditë nga data e dorëzimit të ofertave”, të riformulohet si më poshtë:

“jo më vonë se 7 ditë nga data e dorëzimit të ofertave”.

Argumentimi:

Nga auditimi i zbatimit të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, ka rezultuar se :

1. Njësia e prokurimit, është përcaktuar të ngrihet me 3 specialistë të lartë, nga të cilët njeri duhet të jetë jurist, por nuk është përcaktuar që në përbërje të kësaj njësie duhet të jenë specialistë të fushës, të cilët janë po aq të nevojshëm sa juristi. Mungesa e specialistëve të fushës, për vlerësimin e fondit limit, të projekteve, të specifikimeve teknike dhe kërkesave të veçanta për kualifikim, ka shkaktuar shpesh herë pasoja të dëmshme për konkurrencën, barazinë në tender dhe buxhetin publik.

2. Njësia e prokurimit, si strukturë e specializuar dhe hartuese e dokumenteve të tenderit, nuk ka detyrim ligjor për të ndikuar në zbatimin e ligjit gjatë vlerësimit të dokumenteve të paraqitura nga kandidatët në tender. Prandaj, roli i saj në certifikimin e dokumenteve të paraqitur nga

kandidatët është shumë i rëndësishëm për të parandaluar shkeljet dhe subjektivizmin gjatë kualifikimit të konkurrenteve nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjë që është konstatuar dhe gjatë këtij auditimi.

3. Kohëzgjatja e procedurës, nga data e dorëzimit të ofertave deri në hartimin e renditjes përfundimtare është përcaktuar deri 20 ditë. Kjo periudhë është shumë e gjatë, pasi përveç vonesës në prokurimin e fondeve publike, mundëson edhe marrëveshjet e fshehta ndërmjet konkurrentëve të identifikuar në garë, për deformimin e konkurrencës dhe si e tillë konsiderohet si periudhë risku.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Kryetari i Komunës dhe administrata, të marrë masa për hartimin e planit për ngritjen e sistemit të MFK dhe metodologjinë e zbatimit të tij; të ngrihet struktura për MFK dhe të bëhen emërtesat sipas ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të bëhet implementimi i planit për ngritjen e sistemit të MFK sipas ligjit.

Brenda vitit 2012

2. Të gjitha subjektet e pasqyruara në listën nr. 3, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, që janë paguar nga komuna pa lëshuar faturë tatimore për shërbime të ndryshme, bazuar në UMF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” kreu 14, pika 124.1 dhe 127.2, të detyrohen që të lëshojnë faturat tatimore dhe të paguajnë një gjore në masën 10 % të shumës së faturës (ose 100 % e nivelit të tatimit mbi të ardhurat që lidhet me këtë faturë).

Menjëherë

3. Të ngrihet një komision me specialist të licencuar, për vlerësimin e mjetit tip “Fadrom”, si për dokumentacionin ligjor dhe për vlerën reale, bazuar në vlerën që ka aplikuar Dega e Doganës me rastin e zhdoganimit, dhe nëse rezulton diferencë krahasuar me vlerën e blerjes, të ngarkohen me përgjegjësi personat që kanë realizuar procedurat e prokurimit.

Menjëherë

4. Të bëhet verifikimi dhe inventarizimi i të gjitha sipërfaqeve të ndërtesave, të lokaleve të biznesit, të xhiros së bizneseve, të sipërfaqeve të tokës, të numrit të banorëve sipas familjeve, të bizneseve që operojnë në juridiksionin e komunës dhe të ngarkohen me detyrimin tatimor sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

Brenda vitit 2012

5. Të evidentohen dhe listohen subjektet që brenda territorit administrativ të Komunës Qukës kanë shfrytëzuar pasuritë nëntokësore minerare dhe në rakordim me Degët e Doganave Durrës dhe Qaf Thanë, për mineralet e faturuara nga subjektet që janë marrë me shfrytëzimin e pasurive natyrore të territorit administrativ të komunës gjatë viteve 2009-2011, të kërkohet arkëtimi i rentës minerale që do rezultojë.

Menjëherë ose brenda datës 30.9.2012

6. Të evidentohen subjektet që merren me shfrytëzimin e inerteve brenda territorit administrativ të komunës, e më pas të kryhen rakordimet me Degën e Tatimeve Elbasan, për deklarimin e xhiros nga këto subjekte dhe të kërkohet pagesa e rentës sipas ligjit.

Deri më datë 30.9.2012

7. Të pezullohet aktiviteti i 5 subjekteve të pa licencuara që shfrytëzojnë pasuritë natyrore të komunës, e konkretisht: [REDAKTUAR], si dhe aktiviteti i subjektit “[REDAKTUAR] me leje

- Vlera prej **7,006,481 lekë** nga sipërmarrësi [REDACTED], për objektin “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Fshati Berzeshtë”.
- Vlera prej **98,840 lekë** nga z. [REDACTED], mbikëqyrës në objektin “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Fshati Berzeshtë”.
- Vlera prej **388,944 lekë**, nga sipërmarrësi [REDACTED], për objektin “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Qukës - Shkumbin”.
- Vlera prej **4,795 lekë**, nga z. [REDACTED], mbikëqyrës në objektin “Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Qukës - Shkumbin”
- Vlera prej **1,350,870 lekë**, nga sipërmarrësi [REDACTED], për objektin “Rikonstruksion Shkolla 9-Vjeçare Berzeshtë”.
- Vlera prej **126,235 lekë**, nga sipërmarrësi [REDACTED], për objektin “Rikonstruksion i rrugës së Xhamisë Qukës-Shkumbin, Rikonstruksion i rrugës lagjja Alles Berzeshtë”.
- Vlera prej **62,000 lekë**, nga sipërmarrësi [REDACTED], për objektin “Rikonstruksion i rrugës së Xhamisë Qukës – Shkumbin fazë e II-të”.
- Vlera prej **4,242,748 lekë**, nga [REDACTED], për objektin “Rikonstruksion Shkolla 9-DRITAJ”.
- Vlera prej **227,704 lekë**, nga Njësia e Prokurimit, e përbërë nga z. [REDACTED], znj. [REDACTED] dhe znj. [REDACTED], për objektin “Rikonstruksion Shkolla 9-DRITAJ”.
- Vlera prej **3,043,743 lekë**, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga znj. [REDACTED], z. [REDACTED] dhe z. [REDACTED], për objektin “Rikonstruksion Shkolla 9-DRITAJ”.
- Vlera prej **128,535 lekë**, nga projektuesja zj. [REDACTED], për objektin “Rikonstruksion Shkolla 9-DRITAJ”.
- Vlera prej **768,500 lekë**, nga [REDACTED], për objektin “Ndërtim i urës tip beli, Fshati Gurrë”.
- Vlera prej **937,841 lekë** nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga znj. [REDACTED], z. [REDACTED] dhe z. [REDACTED], për objektin “Rikonstruksion Shkolla 9-vjeçare Berzeshtë”.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

1. Mbështetur në nenin 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu X, të kërkohet nga Agjencia e Prokurimit Publik, që për shkeljet e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën 2009-2011, të marrë masa për anëtarët e Njesisë së Prokurimit si më poshtë :

- **zj. [REDACTED]**, juriste e Njesisë së Prokurimit (në 11 tenderë) për shkelje të neneve 12 dhe 23, të ligjit të mësipërm, gjobë në masën **70,000 lekë**.
- **z. [REDACTED]**, specialist i Njesisë së Prokurimit (në 4 tenderë) për shkelje të neneve 12 dhe 23, të ligjit të mësipërm, gjobë në masën **50,000 lekë**.
- **z. [REDACTED]**, Specialist i Njesisë së Prokurimit (në 3 tenderë) për shkelje të neneve 12 dhe 23, të ligjit të mësipërm, gjobë në masën **50,000 lekë**.
- **zj. [REDACTED]**, specialist i Njesisë së Prokurimit (në 4 tenderë) për shkelje të neneve 12 dhe 23, të ligjit të mësipërm, gjobë masën **50,000 lekë**.

Shkeljet konsistojnë :

a. Për llogaritjen e kufirit monetar, Njësia e Prokurimit (NP), ka marrë për bazë vlerën e preventivave të hartuar nga projektuesit, çmimet e të cilëve nuk janë bazuar në analizat teknike të çmimeve të miratuara nga organet shtetërore, gjë që bie në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për prokurimin publik”, kreu II, pika 2, shkronja "c", VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së koston dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pika 2, ku përcaktohet qartë se përlllogaritja e vlerës limit,

bëhet në bazë të çmimeve zyrtare të publikuara, çmimet e tregut, apo përvoja e mëparshme, gjë që ka shkaktuar edhe dëm ekonomik për buxhetin e Komunës.

b. Hartimin e dokumenteve të tenderit, pasi NP, për dokumentacionin teknik, nuk ka administruar në dosje, dokumente që të vërtetojnë se projektet e preventivat e hartuar nga projektuesit janë zyrtar, e konkretisht mungojnë:

- zhvillimi i procedurës së prokurimit për përzgjedhjen e projektuesit dhe kontrata e porosisë;

- detyra e projektimit;

- projektidea dhe preventivi paraprak;

- akti i marrjes në dorëzim të projektit, miratimi nga Kryetari dhe Sekretari i KRRT-së;

- dokumentet e tjerë standard, të cilët janë nën përgjegjësinë direkte të NP për tu hartuar, në disa raste nuk janë plotësuar dhe zyrtarizuar sipas formës ligjore.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, nenet 41, 46 dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V, pika 2, shkronja a, dhe ngarkojnë me përgjegjësi personat e sipërcituar.

c. Në kushtet e përgjithshme të kontratave dhe lidhjen e kontratave, nuk është parashikuar afati i garancisë së punimeve sipas nenit 866, të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, me ndryshime, ku afati i garancisë për objektet që kanë destinacion përdorimi afat gjatë, është 10 vjet, gjë që ngarkon me përgjegjësi juristin e NP që ka konceptuar kontratat, etj. Shkeljet e mësipërme janë.

2. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pikës 1, 3, 4 paragrafi ¾. 17, 18, 19, pikës 3, 3/a,b,c, 7/e të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, pikës 8, 8/1, 8/2, 10, të kreut 2, pikat 4, 5 të kreut III të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” i propozohet

Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor dhe Urbanistik, pranë Komunës Qukës, **të vendosi gjorbë** ndaj subjekteve të mëposhtme:

- **z.** ■■■, me licencë MK 1245/1 me vlerë **150,000 lekë**, për shkelje të procedurave ligjore si mbikëqyrës në objektin “Rikonstruksion i Rrugës Berzeshtë”, trajtuar hollësisht në kreun e 5-të të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

- **z.** ■■■, me licence MK 1060 me vlerë **50,000 lekë**, për shkelje të procedurave ligjore si mbikëqyrës në objektin “Rikonstruksion i Rrugës Xhamisë Qukes Shkumbin (fazë e parë + fazë e dytë).

- **zj.** ■■■, me licencë MK 1444 me vlerë **50,000 lekë**, për shkelje të procedurave ligjore si kolaudatore në objektin “Rikonstruksion i Rrugës Berzeshtë”.

- **zj.** ■■■ me licence MK 1513/1 me vlerë **50,000 lekë**, për shkelje të procedurave ligjore si kolaudatore në objektet “ Rikonstruksion i Rrugës Xhamisë Qukes Shkumbin (fazë e parë + fazë e dytë) dhe “ Rikonstruksion dhe asfaltim i Rrugës Qukes Shkumbin.

- **z.** ■■■, me licence MK 0678/1 me vlerë **50,000 lekë**, për shkelje të procedurave ligjore si mbikëqyrës në objektin “Rikonstruksion dhe asfaltim i Rrugës Qukes Shkumbin.

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur ne nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” me ndryshime dhe Kontratën Individuale të Punës, të jepen këto masa disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim” për largim nga puna, për punonjësit e mëposhtëm:

- z. ■■■, me detyrë përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave, për periudhën 12.9.2011 e në vazhdim;
- zj. ■■■, me detyrë inspektore tregu, për periudhën 12.9.2011 e në vazhdim;
- z. ■■■, me detyrë inspektor i taksave, për periudhën 12.9.2011 e në vazhdim;

Pasi, gjatë kryerjes së detyrave të tyre kanë kryer shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” neni 4, pika 7, neni 11, aneksi V, neni 22, aneksi 1 neni 23 aneksi 2, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, ndryshuar me ligjin nr. 10280, datë 20.5.2010, neni 2, pika 4, udhëzimet e Ministrisë së Financave nr. 20/1, datë 26.02.2009 dhe nr. 7/1, datë 22.02.2010 “Për përgatitjen e buxhetit vendor” e konkretisht:

- Parashikimi i të ardhurave është kryer në mënyrë të pa studiuar dhe me rezerva.

Regjistrat e taksave nuk janë azhurnuar dhe nuk kanë të pasqyruar shumë gjithsej të planit dhe shumë gjithsej të realizimit. Nuk janë hapur kartelat analitike të subjekteve me të dhënat përkatëse, me detyrimet dhe pagesat, etj.

- Kontrolli tatimor nuk ka qenë në nivelin e duhur nga ana e punonjësve të ngarkuar për vjeljen e taksave, e konkretisht:

i. Për vitet 2009-2010, nuk është ushtruar asnjë kontroll i dokumentuar për sasi të mineraleve të prodhuara dhe të dokumentuara në doganë, e si pasojë nuk është arkëtuar asnjë lekë. Nga auditimi rezultoi se aktualisht zhvillojnë aktivitet në shfrytëzimin e pasurive natyrore të komunës 11 subjekte, nga të cilat vetëm 4 subjekte kanë gjeneruar të ardhura për komunën, por nuk dihet se sa është vlera që duhej arkëtuar, pasi nuk janë kryer rakordimet përkatëse.

ii. Në subjektet e tjera të biznesit, për 3 vitet objekt auditimi, kontrolli për grumbullimin e taksave vendore nuk ka qenë permanent dhe i dokumentuar, ku si pasojë u konstatuan diferenca në ngarkesën tatimore.

- Gjendja e debitorëve është e lartë krahasuar me nivelin e të ardhurave gjithsej. Nga 49 subjekte të biznesit të vogël, 20 prej tyre nuk kanë shlyer detyrimet. Ndërsa, nga biznesi i madh 8 subjekte nuk kanë shlyer detyrimet.

- z. ■■■, me detyrë punonjës policie i komunës, për periudhën 7.9.2011 e në vazhdim, pasi ka ushtruar detyrën pa plane javore, mujore e vjetore; pa plane të veprimt dhe rikonicionit të terrenit sipas situatave të parashikuara; pa patur blloqe të formularëve për mbajtje procesverbalesh konstatimi, pezullimi apo të ndonjë mase tjetër administrative ndaj kundërvajtësve të ndryshëm. Gjatë periudhës në detyrë, nuk ka mbajtur asnjë procesverbal konstatimi, pezullimi apo të ndonjë mase tjetër administrative dhe nuk ka aplikuar asnjë masë gjobë ndaj kundërvajtësve të ndryshëm.

Shënim:

Për ish punonjësit e mëposhtëm :

- zj. ■■■, me detyrë ish-përgjegjëse e Zyrës së Tatim Taksave,
- z. ■■■, me detyrë ish-përgjegjës i Zyrës së Financës,
- zj. ■■■ me detyrë ish-police
- z. ■■■ me detyrë ish-police,

nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk

janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimin e tyre.

D. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, neni 248 “Shpërdorim detyre” të bëhet kallëzim penal për:

1. Z. ■■■, me detyrë ish Kryetar i Komunës Qukës, për periudhën e audituar nga data 01.01.2009 deri më 14.7.2011, pasi gjatë ushtrimit të detyrës, ka kryer veprime dhe mosveprime të kundërligjshme, të cilat përbëjnë mospërbushje të parregullt të detyrës, gjë që ka sjellë përfitime materiale dhe jo materiale të padrejta për personat e tjerë, në dëm të interesave publike.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Pal Gjoni, Irma Shkupi, Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT